



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 4111/1 Prot

Elbasan më 04/08/2025

VENDIM

Nr 38 datë 03/08/2025.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin KORRIK 2025

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin KORRIK 2025, 75 familje me fond 230.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Sokol Sinani



Kryetar i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

Miratuar datë _____

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____

4111/2
10.08.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 947/1 Prot

Elbasan, më 10.8.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.98, datë 03.09.2025 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Korrik 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 4110/1 Prot

Elbasan më 04 /09 / 2025

VENDIM

Nr. 99 datë 03 /09 / 2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin KORRIK 2025
Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

V E N D O S I

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **KORRIK 2025** gjithsej 253 familje me një fond prej 1.214.411 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Sokol Sinani

Kryetar I Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

Miratuar datë _____
Pro _____
Kundër _____
Abstenim _____



4110/2
10.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 257/ Prot

Elbasan, më 10.9.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.99, datë 03.09.2025 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 4099/1 prot.

Elbasan, më 04.09.2025

VENDIM

Nr. 100, date 03.09.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TË QEVERISJES
VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)**

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjit nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 16.07.2025, si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

Vendosi:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarësimin e Bashkisë Elbasan në këtë SKP, të quajtur “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Elbasan në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit dhe marrëveshjes bashkëlidhur.

3. **Të miratojë efektet financiare** të anëtarësimit të Bashkisë Elbasan në TALGA dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondet e parashikuara për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, në përputhje me planin e financimit të përbashkët dhe vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të TALGA.
4. **Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Elbasan** të nënshkruajë marrëveshjen për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta TALGA dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore e administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e saj.
5. **Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Elbasan** të përfaqësojë Bashkinë në organet vendimmarrëse dhe ekzekutive të TALGA-s dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e marrëveshjes dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë prej saj.
6. **Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria Juridike** për zbatimin e këtij vendimi.

<u>Konceptoi:</u>	Koordinatori	L.Haxhiymeri
<u>Pranoi:</u>	Drejtori D.J	A.Hoxha
	Drejt.Finances	A.Mekja



Sekretari

Sokol SINANI



Kryetari

Lutfi LALA



4083/2
10.08.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 179 Prot.

Elbasan më 10 8 . 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.100 datë 03.09.2025 “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA)”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

Nr. 4143/1 Prot

Dt. 04 . 09 2025

VENDIM

Nr. 101 , datë 03.09.2025

Për një ndryshim ne VKB Nr.43 Dt.30.04.2025 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike ne administrim te ASHPU”

Bazuar në:

1. Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,neni 54
2. Ligjin nr.10296,datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
3. Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

VENDOSI:

1. Të miratojë normativat e konsumit të karburantit për mjetet e reja (Fuoristrade me karroceri me targe AB567UO dhe Kamioncin me 3.5 ton me vinc me targe AB785UK) në administrim të Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane Elbasan.
- 2.Ngarkohet Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konceptoi: S.Finance Blerina Kotorri

P/Sek Teknik dhe mekanik Erind Osmani

Pranoi: Dr. Pergj Agron Lulaj

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



4148/2
10.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 980/1 Prot

Elbasan, më 10.9.2025

Lënda: Konfirmim akti


KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.101 datë 03.09.2025 “Për një ndryshim në VKB nr.43 datë 30.04.2025 ” Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPU”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 4027/ prot

Elbasan me 04/05, 2025

VENDIM

Nr. 102, datë 03/05/2025

Mbi miratimin për Planin Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, pasi shqyrtoi rishikimin e Planit Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028 i paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, në mbështetje të nenit 28/1 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji nr. 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë" Ligji nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" Ligji Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar" Ligji 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar Ligji 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar

VENDOSI

1. Të miratojë në parim Planin Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028".
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori DMPS E.Kolla

Drejtori Buxhet-Financë A.Merkja

Drejtori Juridik A.Hoxha

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

Lutfi LALA

4027/2

10.9.2025



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE
FUNKSIONEVE TË DELEGUARA**

Nr. 9811 prot.

Elbasan, më 10.9.2025

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.102 datë 03.09.2025, "Mbi Miratimin për Planin Vendor të Veprimit të Mbrojtjes Sociale 2025-2028", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





982
04.03.2025
REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK



Nr. 4164/1

Elb. 04.03.2025

VENDIM

Nr. 103 datë: 03.03.2025

PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË EKONOMISË PYJORE "KUSHË-1" DHE "ZARANIKË".

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; V.K.M nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" të ndryshuar; ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet" neni 11.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Të miratojë në parim Planin e mbarështrimit të ekonomisë pyjore "Kushë-1" dhe "Zaranikë".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve (A.SH.P.R).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

KRYETARI

Lutfi Lala

Miratuar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____/____ 2025

Konceptoi: Jakov Bodurri

Pranoi: Klajd Gripshi

Miratoi: Altin Cenolli

Konfirmoi: Arben Hoxha

4146 / 2
10.08.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 821 prot.

Elbasan, më 10.9.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.103 datë 03.09.2025 “Për miratimin paraprak të planit të mbarështimit të Ekonomisë Pyjore “Kushë 1” dhe ”Zaranikë””, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 3825/1 prot.

Elbasan, më 04 . 03 .2025

VENDIM

Nr. 104, date 03.03.2025

PËR MIRATIMIN E “PLANI TË INTEGRITETIT 2025 - 2028, BASHKIA ELBASAN”

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 23.04.2018, “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit në institucionet publike”; Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion 2024–2030; VKM nr. 873, datë 24.11.2021, “Për miratimin e rregullave të etikës në administratën publike”; kuadrin ligjor dhe strategjik të integritetit dhe etikës në administratën publike;

VENDOSI:

1. Të miratohet “Plani i Integritetit 2025–2028” i Bashkisë Elbasan, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Këshilli Bashkiak, Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Koordinator i Integritetit, Koordinator i Performancës dhe administrata e Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Koorditore L.Haxhiymeri
Pranoi: Drejtori D.J. A.Hoxha
Drejt.Finances A.Mekja

Sekretari

Sokol SINANI

Kryetari
Lutfi LALA

3825/2
10.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE
FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 1831 prot.

Elbasan, më 10.9.2025

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.104 datë 03.09.2025, "Për Miratimin e "Planit të Integritetit 2025-2028, Bashkia Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 3652/1 prot.

Elbasan, më 04.09.2025

VENDIM

Nr. 105, date 03.09.2025

PËR MIRATIMIN E “KODIT TË SJELLJES 2025, BASHKIA ELBASAN”

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; VKM nr. 873, datë 24.11.2021 “Për miratimin e rregullave të etikës në administratën publike”; Kuadrin kombëtar të integritetit dhe etikës në sektorin publik; Strategjinë Kombëtare Antikorrupsion 2024–2030;

Vendosi:

1. **Miratohet “Kodi i Sjelljes 2025” i Bashkisë Elbasan**, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse e tij.
2. **Ngarkohet Këshilli Bashkiak, Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Administratës dhe Burimeve Njerëzore**, Koordinatori i Integritetit, Koordinator i Performancës dhe administrata e Bashkisë për:
 - o integrimin e dispozitave të Kodit të Sjelljes në praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe në programet e zhvillimit të kapaciteteve;
 - o organizimin e trajnimeve mbi etikën dhe integritetin për stafin e Bashkisë;
 - o monitorimin e respektimit të dispozitave të Kodit dhe adresimin e rasteve të shkeljes së tij;
 - o raportimin çdo vit pranë Këshillit Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit, duke publikuar informacionin për transparencë në faqen zyrtare të Bashkisë.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, **çfuqizohet** Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 185, datë 04.12.2019 “Për miratimin e Kodit të Sjelljes Administrative të Bashkisë Elbasan.
4. **Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

Konceptoi: Koorditore L.Haxhiymeni

Pranoi: Drejtori D.J A.Hoxha

Drejt.Finances A.Mekja

Sekretari

Sokol SINANI

Kryetari

Lutfi LALA

3652/1
10.08.2025



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE
FUNKSIONEVE TË DELEGUARA**

Nr. 8741 prot.

Elbasan, më 10.8.2025

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.105 datë 03.09.2025, "Për Miratimin e Kodit të Sjelljes 2025, Bashkia Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3955/1 Prot.

Elbasan, më 04.09. 2025

VENDIM

Nr. 106, datë 03.09. 2025

PËR MIRATIMIN E “PLANI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
2025 – 2028, BASHKIA ELBASAN”

Mbështetur në Nenin 32 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për hartimin e planeve vendore të arsimit parauniversitar; Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021–2026; Relacionin shpjegues të Bashkisë Elbasan mbi Planin Vendor të Arsimit Parauniversitar 2025–2028, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

- 4- Miratimin e **Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar 2025–2028** i Bashkisë Elbasan, si dokument strategjik që përcakton objektivat, prioritetet dhe masat për zhvillimin e arsimit parauniversitar në territorin e bashkisë.
- 5- Ky plan është pjesë integrale e dokumenteve të zhvillimit afatmesëm të Bashkisë dhe shërben si udhërrëfyes për përfshirjen e masave për arsimin në programimin dhe zbatimin e buxhetit vendor.
- 6- Ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës në Bashkinë Elbasan, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorinë e Financës dhe çdo strukturë tjetër përkatëse, për zbatimin dhe raportimin periodik të Planit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

SEKRETARI

Sokol Sinani

Koncepti:

Drejtoria e DASHRMDS
Drejtoria e DPKSAPR,
Drejtoria Juridike:
Drejtoria Buxhet & Financë:
Zv/kryetar:

K.Lala
D.Rroseni
A.Hoxha
A.Merkja
A.Shehu

KRYETARI

Lutfi Lala



3955/2
10.08.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE
FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 9857/prot.

Elbasan, më 10.9.2025

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.106 datë 03.09.2025, "Për Miratimin e "Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar 2025-2028, Bashkia Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4246/1

Elb. 04.08.2025

V E N D I M

Nr. 106, datë 03.08.2025

PËR MIRATIMIN E KRYERJES SË STUDIMIT TË POTENCIALIT TË ERËRAVE,
ME SYNIM NDËRTIMIN E PARQAVE EOlike NË BASHKINË E ELBASAN

Këshilli bashkiak pasi shqyrtoj materialin e paraqitur nga administrata e bashkisë në lidhje me projekt-idene e hartuar nga subjekti i licësuar për këtë qëllim "SOFIR ALBANIA" Sh.p.k "Për studimin e potencialit të erërave, me synim të ndërtimit të parqeve eolike", në mbështetje të bazës ligjore të mëposhtëme:

- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 3, 4, 8, 9 dhe nenet 22 deri 28;
- Ligjit nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për pyjet", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", i ndryshuar, i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministave nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...", i ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.1, dt.9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik".

V E N D O S I

- Të lejoj subjektin "SOFIR ALBANIA" Sh.p.k të bëjë studimin e potencialit të erërave në territorin e bashkisë Elbasan nëpërmjet kullave Anemometrike provizore (2 copë) me sipërfaqe totale **0.4 ha** në zonën e Labinotit për një periudhë **24** mujore (sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi).
- Pagesa për përdorimin e fondit pyjor për efekt studimi do të jete sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 "Për çmimet dhe tarifat e përdorimit të fondit pyjor", shtojca nr.1, pika 8 me vlerën totale 184,000 (Njëqind e tetëdhjetë e katërmijë) lekë.
- I gjithë operacioni i instalimit të kullave anemometrike të kryhet nën mbikqyrjen e Specialistit të pyjeve për të pasur një zbatim rigoroz sipas projektimit dhe inpakt sa më minimal mbi mjedis.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Sokol Sinani

Konceptoi: Q. Poka

Pranoi: J. Bodurri

Miratoi: K. Gripshi

KRYETAR

Lutfi Lala

Miratur me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____/____/2025



4246/2
10.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 387/1 prot.

Elbasan, më 10.9.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.108 datë 03.09.2025 "Për miratimin e kryerjes së studimit të potencialit të erërave me synim ndërtimin e parqeve Eolike në Bashkinë Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 2818/1 Prot

Elbasan më 04.09.2025

VENDIM

Nr. 103, Datë 03.09.2025

“Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan Z. Luan Rama ”

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e tij të datës __.09.2025, mbështetje të nenit 49, pika 4, shkronjat “b” dhe pika 5, të nenit 54 shkronja “j” dhe të nenit 55 pika 3 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”:

VENDOSI

1. Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan, Z.Luan Rama, përfaqësues i subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë , për arsye të dhënies së dorëheqjes nga mandati si anëtarë i Këshillit Bashkiak.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konc. S.Gjorga

SEKRETARI

Sokol Sinani

KRYETARI

Lutfi Lala

2818/2
10.08.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 978/1 Prot.


Elbasan më 10.9. 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.109 datë 03.09.2025 “Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan Z.Luan Rama”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Ilir BEJTJA



REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 4328/1 Prot

Datë, 04.09.2025

VENDIM

Nr. 110 Datë 03.09.2025

Mbi lirimin e sekretarit të Këshillit Bashkiak Elbasan Z. Sokol Sinani

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .09.2025, nisur nga paraqitja e dorëheqjes së Sekretarit të Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 54 pika c, dhe Neni 57, si dhe në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Elbasan:

VENDOSI:

1. Të miratojë lirimin nga detyra të Sekretarit të Këshillit Bashkiak Z. Sokol Sinani.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Këshilli Bashkiak Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala



4329/2

10.9.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 929/ Prot.

Elbasan më 10.9. 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.110 datë 03.09.2025 “Mbi lirimin e sekretarit të Këshillit Bashkiak Elbasan Z.Sokol Sinani”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



990

04.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4234/1 Prot.

Elbasan, më 04.09.2025

Vendim

Nr 111 Datë 03 / 09 /2025

Këshilli Bashkiak, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit, për lirim të ambjenteve të hollit të teatrit “Skampa” bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

Vendosi

- 1- Ambjentet e hollit të teatrit “Skampa” të lirohen dhe përdoren në funksion të aktivitetit të vetë teatrit.
- 2- Bashkia të njoftojë bashkëpronarët dhe të marrë masat për shpërblimin e tyre për përdorimin e godinës sipas vendimit nr 242 datë 17.02.2005 të gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan
- 3- Vendimet e këshillit bashkiak nr 45 datë 25.04.2002 dhe nr 24 datë 24.06.2002, shfuqizohen
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sek. K. Bashkiak
Sokol Sinanaj

Dr. Arti dhe Kultura :
Dr. Përgjithshëm :
Dr Juridike
Dr Pronave dhe Strehimit
Zv/Kryetare

K.Kapaj
A.Kovaçi
A. Hoxha
A. Suli
K. Krasnika

Kryetari
Lutfi Lala



4234 / 2

12.09.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE
FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 990/1 prot.

Elbasan, më 12.9.2025

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.111 datë 03.09.2025, "Për lirim të ambjenteve të hollit të teatrit "Skampa" ", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA